



Republika e Kosovës
Komuna Drenas (Glogoc)
Kuvendi i Komunës
Nr. 02-400/01-25744 dt. 31/05/2023



Bazuar në nenin 11,12, dhe 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Nr. 12-320-19338 dt. 07.04.2017, Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr.400/01-18380 e datës 27.4.2022, si dhe Kërkesës të palës, Nr. 01-070/01-0023340/23, dt. 17.5.2023, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë **26.05.2023**, e cila vazhdoi me dt. 31.05.2023 miratoi këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Kërkesës, Nr. 01-070/01-0023340/23, dt. 17.5.2023, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes – kancer ovarian, në shumën totale prej 3,000.00 euro

Neni 1

Me këtë vendim në përputhje me Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 12-320-19338 dt. 07.04.2017 si dhe rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr.400/01-18380 e datës 27.04.2022, propozohet miratimi i Kërkesës Nr. 01-070/01-0023340/23, dt. 17.5.2023, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes – kancer ovarian, në shumën totale prej 3,000.00 euro.

Neni 2

Mjetet financiare të aprovuara sipas këtij Propozim Vendimi do të paguhën nga pozicioni, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere/kodi ekonomik 21/611/73010/21200/00000/0760, të parapara me buxhetin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Buxhetin për vitin 2023, ndërsa transferi do të bëhet përmes xhirollogarisë në emër të **Fisnik Dobra, PCB, nr. i kontos: 1110209338000146**.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale –DSHMS si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

ARSYETIM

Me datë 17.5.2023, pranë Zyrës së Kryetarit është adresuar kërkesa me numër Nr. 01-070/01-0023340/23, dt. 17.5.2023, përmes së cilës pala Fisnik Dobra, ka adresuar nevojën e tij për mbështetje financiare për trajtimin urgjent mjekësor të bashkështrës së tij, Valdete Rexhepi Dobra, me kancer ovarian, sëmundje të cilën e ka dëshmuar edhe me dokumente mjeksore.

Komuna e Drenasit brenda kompetencave të saja ligjore dhe buxhetore, e ka të rregulluar këtë çështje përmes Rregullores së brendshme komunale - Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 12-320-19338 dt. 07.04.2017 si dhe rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr.400/01-18380 e datës 27.04.2022 e cila parasheh se Komuna subvencionon në formë të përkrahjes financiare banorët rezidentë të Komunës së Drenasit për përballimin e shpenzimeve të shërimit nga sëmundjet e rënda, rehabilitimit, për rastet emergjente shëndetësore, për familjet që janë në gjendje të vështirë ekonomike dhe sociale sipas kriterëve të përcaktuara me të njëjtin dokument/rregullore, ku edhe duke u bazuar në këtë, përmes këtij dokumenti, propozohet që në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe brenda kompetencave të veta, Kuvendi i Komunës të aprovojë kërkesën e qytetarit të komunës së Drenasit z. Fisnik Dobra për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes – kancer ovarian, në shumën totale prej 3,000.00 euro si rast i cili i plotëson kriteret për subvencionim emergjent për çështje shëndetësore dhe mirëqenie sociale dhe njëkohësisht si rast i cili kërkon veprim të menjëhershëm nga ana e jonë duke i mundësuar palës së lartëcekur vazhdimin e trajtimit të nevojshëm mjekësor për bashkëshorten e tij.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Radni i Transferi -
Ministry of Finance, Labour and Transfers

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansija
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive

Nr. i llogareve
Broj stranica
No pages
Dafina

Nr. i llogareve
Broj stranica
No pages
Dafina

Nr. i llogareve
Broj stranica
No pages
Dafina

PRISTINEJA

HYRJE - KLAZMA - INDEXING
Klasifikimi i dokumentit
Klasifikimi i dokumentit

30.06.2023

-U/- 020-655/2

Për:	Ramiz Lladrovi, Kryetar i Komunës së Drenasit
Kopje:	Milaim Hajdari, Kryesues i Kuvendit të Komunës Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Resul Makreshi, Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Nga:	Kliti Shala, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Zyrtarët përgjegjës:	Referencë: 141/2023
1. Zytari hartues i vlerësimit ligjor	Bora Duli, Zv. Udhëheqëse e Divizionit për Hartim dhe Harmonizim të Legjislacionit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
2. Zytari konfirmues i vlerësimit ligjor	Kimete Zekaj, Zytare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë të aktit të Komunës së Drenasit
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuari Kryetar z. Lladrovi,

I nderuari Kryesues z. Hajdari,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve; ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

<i>Vendimin Nr. 02-400/01-25744/23, për miratimin e kërkesës për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes – kancer ovarian, në shumën totale prej 3,000.00</i>
<i>I miratuar më datë 26.05.2023</i>
<i>I parashituar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 31.05.2023</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 06.06.2023</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "Ministria"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së akteve të mësipërme të Komunes së Drënasit, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Drënasit, me anë të aktit administrativ që është subjekt i shqyrtimit, synon ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 3,000.00 € (tre mijë euro) për për mjekim urgjent të sëmundjes – kancer ovarian për një qytetar të komunës.
2. Edhe përkundër faktit se Komunave ju jepet pavarësi financiare në menaxhimin e financave të tyre, ashtu të precizuara me nenin 2 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Komunitet obligohen t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtej e tutje referuar si "LMFPP") dhe Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, gjatë disponimit me të hyrat financiare komunale, e përcaktuar si në vijim:

Neni 7
Burimet Financiare Komunale

7.2 Komunitat duhet t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të LMFPP gjatë disponimit me këto burime financiare.

3. Ajo që i faktorizon edhe më shumë detyrimet e përcaktuara me dispozitat e LMFPP-së është neni 81 i LMFPP-së, në të cilin precizohet që në rastet kur ky ligj ka mospërputhje me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, dispozitat e LMFPP-së kanë përparësi, sikurse përshkruhet më poshtë:

Nëni 81
Hyrja në fuqi/Shfuqizimi i legjislacionit paraprirak/Zbatueshmëria

81.1. Në rast mospërputhje me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, që kanë të bëjnë me menaxhimin e parash-publike, dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, do të kenë përparësi, në pajtim edhe me nenin 36 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë: [theks i shtuar]

4. Në rrjedhë të kësaj, LMFPF konsiderohet ligj organik që përcakton kushtet, procedurat dhe konditat ligjore për menaxhimin e mirëfillt të financave publike në përgjithësi, dhe shpenzimin e parash-publike në veçanti.
5. Në kuptim të shpenzimit të rregullt të parash-publike, nenin 17 i LMFPF-së precizon qartë se parash-publike do të përdoren vetëm për qëllime të miratuara publike, si dhe të shpenzohen nga fondet e ndara dhe të alokuara [theks i shtuar].
6. Nisur mbi këtë bazë, Ministria ka konsultuar Ligjin Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, si dhe strukturat përgjegjëse të Ministrisë për buxhetin e Komunës së Drenasit, ku është evidentuar se organizata buxhetore i ka të planifikuara shpenzimet e potencuara me aktin komunal për këtë vit fiskal.
7. Si përfundim, dhe duke marrë për bazë konstatimet e mësipërme, akti administrativ i Komunës së Drenasit është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Drenasit dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkatëzi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.